



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

Numri i kontratës: 101-24-10922-1-3-6/C149

Kuvendi Republikës së Kosovës, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe

Valmire Simnica, BI, Prishtinë, Adresa: Rr. 22 Qershori, nr. 65; E-mail: tahirajvale@gmail.com;
Tel.: +383 45 430 350; NUI: 811986457 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë
pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me material për konferenca – dhurata simbolike,
me numër prokurimi: 101-24-10922-1-3-6 (KU101 24 039 136)

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizimi me material për konferenca – dhurata simbolike

- Dhuratë simbolike / Varëse me brosh - 70 copë.

- Dhuratë simbolike / Brosh 70 copë.

1.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë para aktivitetit. Sesioni i XXXVI-të i Asamblesë Rajonale të Evropës (ARE) të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), që do të mbahet prej datës 10-14 nëntor 2024 në Prishtinë.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë **ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,750.00 €** (njëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetnja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] [*të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet*] [*te kryej ndonjë ose të gjitha punët*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [*furnizimeve*] [*punëve*] [*shërbimeve*] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë

obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.



KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Afatet kohore	1.3	<ul style="list-style-type: none"> Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës. Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë para aktivitetit. Sesioni i XXXVI-të i Asamblesë Rajonale të Evropës (ARE) të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), që do të mbahet prej datës 10-14 nëntor 2024 në Prishtinë.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<ul style="list-style-type: none"> Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe serbe.
Cilësia e furnizimeve	6	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha furnizimet duhet të jenë në pajtim me kërkesat e specifikacionit teknik në Dosje të Tenderit. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë
Dëmet e likuiduara	8	<ul style="list-style-type: none"> Dëme të likuiduara: Autoriteti Kontraktues, për vonesë në furnizim, operatorit ekonomik mund t'ia kalkulojë dëmet e likuiduara 0.25% në ditë deri në 10% të vlerës së kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	13.1	<ul style="list-style-type: none"> Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 13.2
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.2	<ul style="list-style-type: none"> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim:

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare të Ofruesit të Shërbimeve



Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Operatori Ekonomik VALMIRE SIMNICA, BI	
Emri dhe mbiemri	Xhemal Halili	Emri dhe mbiemri	Valmire Simnica
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	V. Simnica
Data:	06.11.2024	Data:	06.11.2024
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Thirrje furnizimi me materiale për konferenca - dhuratë simbolike
№. i Protokollit: 101-14-10922-L-3-6 dhe №. i Bëndëshëm: KUJ001 24 039 158

PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

Nr.	Përshkrimi	Mostro ose ekuivalent	Njësia matëse	Sasia	Çmimi me TVSH (€)	TOTALI me TVSH
1	Dhuratë simbolike / Varëse me brosh, punim dorë me legjendë në gjuhën shqipe dhe përkthim në gjuhën angleze dhe frëngjisht. Dimensionet e broshit: 5x5 cm Dimensionet e varësës: Trashësia e varësës 0.5 cm Gjerësia e varësës 70 cm me Tolerancë në dimensionet: +/-10%.		copë	70	10.00	700.00
1	Dhuratë simbolike/ Brosh punim dorë me legjendë në gjuhën shqipe dhe përkthim në gjuhën angleze dhe frëngjisht. Dimensionet e broshit: 5x5 cm, me Tolerancë në dimensionet: +/-10%.		copë	70	15.00	1,050.00
GJITHSHU OFERTA ME TVSH						1,750.00

Shënime:

Operatori ekonomik duhet t'i japin çmimet reale të tregut për shërbimet e ofruara.
Çmimet jo-normale të shtesë dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK

EMRI I KOMPANISË	Valonine Simnica B /
ADRESA E PLOTË	Bardhi Madh 1022 - bashkësi Bardhi Madh
PËRFACËSUAR NGA:	
EMRI	Valonine Simnica
POZITA	Prenar
MËNSHRIMI	V. Simnica
DATA	28.05.2024
VULA	

